



REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 594 Prot

Elbasan më 20.11.2025

NJOFTIM

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së rradhës së Këshillit Bashkiak Elbasan.

Ju njoftojmë se më datë **27.11.2025** ora **13:00** në sallën e Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan zhvillohet mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Elbasan e thirrur nga Kryetari i Këshillit Bashkiak në bazë të Ligjit 139/2015, neni 53 pika 3), me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së Mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbalit të muajit Tetor 22.10.2025
3. Për dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Znj. Erjona Ibrahim Jaurri
4. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Tetor 2025
- 4.1. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin Tetor 2025
5. Për disa ndryshime në nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan, për vitin fiskal 2026.
6. Mbi miratimin e listës emërore të familjeve që do të përfitojnë subvencionim qiraje, për vitin 2026, në qytetin e Elbasanit.
7. Detajim i shtesës së fondeve për SHMZSH
8. Për korrigjimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga dëmtimi i banesës, si pasojë e rrëshqitjes së tokës së Z. Pren Mihal Bërdufi banorë në Fshatin Stërstan, Njësia Administrative Gjinar, përcaktuar në VKB Nr. 172 datë 04.12.2019 të Bashkisë Elbasan.
9. Për korrigjimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djëgia e banesës së Z. Myftar Ibrahim Dervishi banorë në Fshatin Xibrakë, Njësia Administrative Labinot Fushë, përcaktuar në VKB Nr. 162 datë 27.11.2020 të Bashkisë Elbasan.
10. Për korrigjimin e ndihmës financiare, dhe miratimin e vlerësimit të dëmeve nga ana ndërtimore dhe dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektro-shtëpiake, të shkaktuara nga zjarri në familjen e Z. Hysen Sali Pisha banorë në Fshatin Benë, Njësia Administrative Labinot Mal, përcaktuar në VKB Nr. 30 datë 20.02.2018 të Bashkisë Elbasan.
11. Për korrigjimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga dëmtimi i banesës, si pasojë e rrëshqitjes së tokës së Z. Hasan Xhevit Muzhaqi banorë në Fshatin Polis i Vogël, Njësia Administrative Shushicë, përcaktuar në Vendimin Nr. 84 datë 12.06.2015 të Këshillit të Komunës Shushicë, Elbasan.
12. Për miratimin e kriterëve mjedisorë dhe vizuale për licencimin e mjeteve taksi (4+1) në Bashkinë Elbasan



13. Relacion për transferimin e asetëve nga Agjencia e Mbikqyrjes dhe kontrolli tek Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale dhe Bashkia Elbasan
14. Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
15. Për miratimin e planit të aktiviteteve, konsultimeve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak Elbasan, viti 2026

Të ndryshme,

Komisionet do të mbledhen ditën e premte date 21.11.2025 në orën 13:00 në ambientet e Bashkisë Elbasan, salla e mbledhjes së komisioneve.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

LUTFI LALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN
KRYESIA

Nr. _____ prot.

Elbasan më 20. 11. 2025

VENDIM

Nr _____, datë _____. _____. 2025

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 17, 56, 57 dhe Rregulloren për Organizmin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Elbasan, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Elbasan, në mbledhjen e datës 20. 11. 2025.

VENDOSI

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Elbasan, e cila do të mbahet në datën 27. 11. 2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Elbasan, deputetët e qarkut dhe personat apo /dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i këshillit - Lutfi Lala

Zv. Kryetar i këshillit – Zamir Muzhaqi

Zv. Kryetar i këshillit – Enerieta Ferra

